

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*

02.11.2020

Ora 11:00

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i projektaktit “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues i nismës ligjore, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve për projektligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

Z.Ilirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

Z.Erion Meta, Shef i Sektorit të Dekriminalizimit

Z.Olsi Peto, jurist

Të tjerë:

Z.Kristaq Kume, shoqëria civile

Znj.Brisida Gjikondi, shoqëria civile

Znj.Enedha Bozheku, shoqëria civile

Z.I.Celibashi: Është paraqitur përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesa e Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, sipas të cilës është kërkuar zgjatja e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”. I japim fjalën Sekretarit ose ndonjë përfaqësuesi tjetër të administratës për një relاتim të shkurtër në lidhje me këtë kërkesë dhe pastaj të interesuarvë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Dt.02.11.2020

Z.Y.Merkaj: Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse z.Kristaq Kume, zj.Brisida Gjikondi dhe zj.Edna Bozheku kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë. Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e mbështesin paragrafit 4 nenit 6, paragrafit 1 nenit 10 të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”. KQZ, me vendimin nr. 11, datë 30.06.2020 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve dhe afatin 3 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për mbledhjen e nënshkrimeve. Në datën 01.10.2020 komiteti përfaqësues ka bërë një kërkesë për shtyrjen e afatit pasi për shkaqe objektive nuk ka mundur t'i mbledhë firmat brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për këto shkaqe dhe arësy mund të marrin fjalën vetë përfaqësuesit e komitetit përfaqësues.

Z.I.Celibashi: Mirë, faleminderit! I japim fjalën zotit Kristaq Kume për të parashtruar argumentat dhe shkaqet pse kërkohet shtyrja e afatit.

Z.K.Kume: Së pari, më lejoni që meqenëse ky është takimi i parë që bëjmë bashkë, i nderuar zoti Celibashi, më lejoni tu uroj suksese, faqebardhë në këtë punë! E bëfsh këtë punë ashtu siç di ta bësh ti! Lidhur me kërkesën që kemi bërë për të shtyrë afatin, e motivuar kjo nga ajo me të cilën ne u ndeshëm gjatë periudhës që u angazhuam për të kërkuar firmat mbështetëse të 20000 qytetarëve, brenda periudhës së kohës që ne propozuam dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi deri në 30 tetor. Më lejoni të parashtroj para jush të paktën tre nga këto arësy. E para, ndoshta po të ishte një situatë ndryshe nga ajo që ne kaluam, nuk

Zbardhi materialin e inçizuar


Stenografia

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*

do të kishte efekt në vlerësimin tim dhe unë kështu e mendoja, fakti që me fletën tip ne u paisëm goxha më vonë se sa vendimi. Dy-tre javë më pas. Gjithësesi nuk është kjo ajo që bëri që ne të ndodhemi sot në këtë situatë për të përsëritur kërkesën për shtyrjen e afatit. Janë dy të dukshme dhe një e cila është, por mund të thuhet dhe mund të mos thuhet. Kjo që mund të thuhet e mund të mos thuhet ka të bëjë me faktin që pavarësisht se ne e nisëm së bashku këtë gjë, kur nisëm dhe menduam se për tre muaj mund ta bëjmë kishim përshtypjen se krahas angazhimit vullnetar do të kishte dhe mbështetje. Nga bisedat që unë kisha konsumuar me donatorë të ndryshëm në një farë mënyre kisha përshtypjen se do të gjeja një mbështetje financiare shumë modeste, për të mbështetur djemtë dhe vajzat që do të punonin për të grumbulluar firmat nëpër qytete. Megjithatë mungesa e kësaj nuk na shkaktoi asnjë efekt, sepse ne e patëm të pamundur që të grumbullonim njerëzit. Që të angazhonim grupet e grumbullimit të firmave për shkak të pandemisë. U kufizuam shumë në krijimin e grupeve nëpër qytete, me vullnetarë për të mbledhur firmat dhe në total ato që kemi marrë kemi qenë të detyruar t'u themi njerëzve të largohen e të mos jenë afér njëri-tjetrit. E dyta, e përjashtuan totalisht mundësinë e grumbullimeve me qytetarë për t'u folur për ç'ka ne kishim nisur të bënim dhe pse e kërkoni mbështetjen e tyre. Shtuar kësaj faktin që situata në përgjithësi është një situatë që po e vuani e gjithë shoqëria tek ne. Është mbarsur shumë dhe me qëndrimin mosbesues që mbajnë njerëzit ndaj të tillë veprimeve. “Kush ju ka sjellë”? “Cila parti”? “Për kë e bën”? nuk arrijnë të kuptojnë akoma faktin që kjo është një nismë e qytetarëve që nuk kanë asnjë interes tjetër përvicë se për të krijuar kushte sa më të mira vehtes së tyre. Të gjitha këto së bashku bënë që ne ta kishim të limituar mundësinë për të marrë firma në atë kohë që menduam se do ta bënim. Kujtoj psh që studentët që ishin targeti kryesor që ne mendonim të merrnim


*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografja
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*

firmat mbështetëse nuk vinin në fakultete për arësyen të pandemisë. Pra, me gjithë dëshirën tonë të mirë, ne nuk arritëm dot. Në këto kushte ne të tre nismëtarët ramë dakord që ti drejtohem Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën për të parë mundësinë e shtyrjes së afatit të grumbullimit të firmave. Për sa kohë që dhe vetë ligji nuk përcakton.., nuk ka të shënuar në ligj që duhet nga kaq kohë të përfundonjë procesi i grumbullimit të firmave, por kërkohet që të shprehet në vendimin e KQZ-së dhe shprehja e vendimit të KQZ-së bëhet sipas propozimit që i bëjnë nismëtarët. Duke qenë se s'ka kufizim në ligj për kohën se kur mund të grumbullohen firmat, ne menduam se është e mbështetur kërkesa për KQZ-në të shohë mundësinë për shtyrjen e këtij afati. Në shkresën tonë është shkruar mundësia e shtyrjes deri në 25 dhjetor, por me atë që po shohim se si po zhvillohet situata, me ç'presim të ndodhë, do të jetë e vështirë dhe data 25 dhjetor. Unë do të kërkoja mirëkuptimin Tuaj që të mos mbani në konsideratë datën 25 dhjetor, por të shihni përtej kësaj date. E dyta, sipas mendimit dhe vlerësimit tonë për situatën që ndodhemi në procesin legjislativ dhe në këtë rast ky proces për Ligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”, vlerësojmë se është shumë pak e mundshme që të jetë objekt i trajtimit para zgjedhjeve, pra nga kuvendi që është sot. Në vlerësimin tonë është që kjo do të jetë objekt shyrimi dhe diskutimi në kuvendin që do të dalë nga zgjedhjet e 25 prillit. Në këtë kuptim do t'u lutesha të krijonit mundësinë që ne të mos kufizohemi nga koha. Ne mendojmë që afati të jetë deri nga marsi i vitit që vjen. Pra, të mos jemi në stresin e kohës, në kuptimin e asaj që jo të jemi komodë për kohën e ta shpërdorojmë kot, por të mund t'i përshtatemi sa më mirë situatës në të cilën ne ndodhemi dhe që presim të ndodhemi. Kjo është arësyja i dashur mik, që ne kërkua që ju të trajtoni dhe njëherë kërkesën tonë për këtë proces, ju faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografja
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*

Z.I.Celibashi: Faleminderit, ndonjë shtesë, ndonjë kërkesë tjetër?

Znj.Brisida Gjikondi: Unë thjesht doja të thoja që siç ndodh edhe në proceset gjyqësore, pavarësisht se kjo është tjetër gjë, kemi shkaqe objektive. Për më tepër që të gjitha vendimet që ka marrë Këshilli i Ministrave për shmangien e grumbullimeve të njerëzve dhe të gjithë aktiviteteve politike këto kohë, që janë të gjitha të reduktuara, janë ende në fuqi, nuk janë shfuqizuar. Ne për hir të së vërtetës, profesori e tha pak me delikatesë, unë po e them tamam. Në rast se vendimi u muar në fund të qershoret, ne na është zbardhur e dhënë në fund të korrikut formulari tip për t'u plotësuar. Gjatë gjithë gushtit dihet që ishte sezoni veror, shtator, tetor, tani jemi në nëntor. Ne kemi mbledhur një sasi firmash nënshkrimesh, sipas ligjit, por nuk janë të mjaftueshme për ta mbyllur si procedim. Ndaj do të donim mirëkuptimin tuaj në rast se shkon deri në mars. Ne e biseduam dhe me profesorin jo në fund të dhjetorit, sepse dihet që tani pritet përsëri një mbyllje e re. Shihen statistikat dhe numrat e infektimeve të reja dhe si pasojë që ka sjellë covid 19, në qoftë se e çojmë deri në fund të marsit do të ishim shumë mirënlohës. Për më tepër që është një iniciativë që ndodh për herë të parë në Shqipëri. Një iniciativë ku 20000 qytetarë me të drejtë vote çojnë në parlament ligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”, më shumë është simbolika shumë e fuqishme për ushtrimin e demokracisë se sa ligji në vetvehete. Edhe ai është shumë i rëndësishëm, por rrugëtimi që është për herë të parë që ndodh në Shqipëri do të ishte diçka madhështore, më falni për hiperbolizimin, në qoftë se ndodh. Prandaj kërkojmë dhe më shumë përkrahjen tuaj qoftë duke na krijuar dhe këtë strukturë. Ne e dimë që ky parlament nuk do e marrë në shqyrtim, por për ne

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU
*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*


ka rëndësi të thyhet akulli dhe të ambientohen njerëzit me fuqinë e tyre. Ne nuk bëjmë bujë, nuk bëjmë zhurmë, nuk kemi bërë deklarata mediatik, duam që si milingonat t'ia arrijmë kësaj. Pra, të mbledhim këto nënshkrime të vërteta dhe të arrimë ta çojmë këtë nismë në parlament, sikurse dhe kushtetuta e njeh, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Po faleminderit, në lidhje me situatën e deritanishme të grumbullimit të firmave mund të kemi ndonjë informacion shkurt se si jemi? Ku jemi?

Z.K.Kume: Firmat.,, shumën nuk e kemi bërë, se një pjesë i kam unë, një pjesë e ka Brisida. Unë kam deri tani 2600-2700 firma të grumbulluara. Brisida nuk e di se sa ka. Pra nuk i kemi mbledhur të gjitha. Kujtoj që pjesa më e madhe e tyre janë bërë. Kristaqi është miku im, jemi duke grumbulluar këtë gjë, më ndihmon dot? Më dërgo formularin e u marr njerëzve firmat. Pra jo duke thirrur qytetarët në tavolina, nëpër qytete, më shumë se sa duke aktivizuar njerëzit që kanë dashur, nëpërmjet mediave sociale i kemi shpërndarë. Kanë qenë shumë që kanë kërkuar të paisen me formularë dhe ta plotësojnë e ta dërgojnë. Kanë qenë pak ata që janë kthyer, por kjo nuk përbën asnjë problem. Di që mund të jenë 5000 e ca, jo më shumë se kaq. Është larg pritshmërive, por është për mendimin tim kaluar mundësive me të cilat ne u përplasëm gjatë këtij procesi të grumbullimit të firmave.

Z.I.Celibashi: Dakord, unë i dëgjova të gjitha argumentat tuaja në lidhje me pamundësinë, referuar jush, objektive të mbledhjes së nënshkrimeve për nismën që

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.02.11.2020*

keni marrë dhe mendoj që ka shkaqe të përligjura për ta pranuar kérkesën tuaj. Në lidhje me afatin, po konsideroj kérkesën e bërë sot, për të pas një afat më të gjatë se ai që ju keni kërkuar me shkrim. Në vlerësimin tim mendoj se deri në datën 28 shkurt 2021 do të ishte një afat objektiv, duke konsideruar të gjitha rrethanat dhe situatat, përfshirë dhe ato që lidhen me situatën e covid 19, për të mundësuar mbledhjen e nënshkrimeve nga ana juaj. Mund të ishte dhe fundi i marsit, por jo pa qëllim e kam vendosur datën 28 shkurt, sepse është periudha kur fillojnë fushatat zgjedhore dhe kjo mund të kompromentonte dhe iniciativën tuaj, por në të njëjtën kohë mund të kompromentonte dhe aktivitetin politik të partive politike. Data 28 shkurt në pikëpamje praktike është si një kufi që e ndan periudhën e aktivitetit tuaj, me periudha të aktiviteteve të tjera.

Z.I.Celibashi: Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 19, pika 2 të Kodit Zgjedhor si dhe në nenin 53, paragrafi 3-të të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, vendosi:

- 1.Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë” deri në datën 28 shkurt 2021.
- 2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot në Tiranë, më 2.11.2020, faleminderit!

Z.K.Kume: Faleminderi, jemi të bindur plotësisht se një vendim i tillë është jo vetëm në funksion të asaj që ne duam të bëjmë, por edhe në funksion të asaj që ne ta bëjmë sa më mirë këtë gjë.

Vendimi nr.18

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*

